



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2007/4 prot.

Tiranë më 26.09.2025

VENDIM

Nr. 32, datë 26.09.2025

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 2007 prot., datë 07.08.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/IdentiTek sh.a..

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës datë 11.06.2025, depozituar nëpërmjet shërbimit postar, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. *Aktet dhe provat e gjeneruara nga ana e Autoritetit Publik, gjatë hetimit administrativ si palë në proçes, “Incidenti i Sigurisë me nr. 1192 prot., datë 19.08.2024”;*
2. *Aktet dhe provat e gjeneruara nga ana e Autoritetit Publik, gjatë hetimit administrativ si palë në proçes, “Incidenti i Sigurisë me nr. 1197 prot., datë 19.08.2024”;*
3. *Aktet dhe provat e gjeneruara nga ana e Autoritetit Publik, gjatë hetimit administrativ si palë në proçes, “Incidenti i Sigurisë me objekt “Shkelje të politikës së sigurisë së informacionit, pika 18.1.4, për sa i takon Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë së informacionit personal.”, raportuar më datë 23.08.2024”;*
4. *Aktet dhe provat e gjeneruara nga ana e Autoritetit Publik, gjatë hetimit administrativ si palë në proçes, kërkuar me shkresën 1175/3 prot., datë*

19.08.2024, me objekt: “Kundërshtimi i fillimit të procedimit disiplinor referuar shkresës nr. 1175/2 prot., datë 15.08.2024 “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore”, IdentiTek sh.a. mbi të cilat bazohet ky fillim procedimi.” (Ju sjellim në vëmendje se në këtë hetim administrativ, janë kërkuar përveç të tjerash edhe hyrje daljet e punonjësve në institucion në format elektronik dhe hard copy);

5. Aktet dhe provat e gjeneruara nga ana e Autoritetit Publik, gjatë hetimit administrativ si palë në proces, Aktet dhe provat e gjeneruara nga ana e Autoritetit Publik, gjatë hetimit administrativ si palë në procesin nr. 1175/9 prot., datë 23.08.2024 me objekt: “Fillimi i hetimit administrativ ndaj anëtarëve të Komisionit Disiplinor, të ngritur për shqyrtimin e procedimit disiplinor që ka filluar me shkresën nr. 1175/2 prot., datë 15.08.2024 “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore”.

Në mungesë të një përgjigje nga ana e Autoritetit Publik, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në kërkesën për informacion.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 2007/1 prot., datë 18.08.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik, të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 25.08.2025.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 979/4 prot., datë 21.08.2025, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2007/2 prot., datë 25.08.2025, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...z. , pretendon se nga ana e IdentiTek nuk i janë vënë në dispozicion kopje dokumentacioni për disa incidente sigurie që ka raportuar gjatë kohës që ai ka qenë i punësuar pranë IdentiTek. Duke qenë se është një ankesë e persëritur nga ky shtetas, jeni në dijeni se ankuesi që prej datës 07.10.2024, nuk është më punonjës i IdentiTek sh.a. dhe se aktualisht, mbi bazën e padive të ngritura nga ky shtetas, mosmarrëveshjet mes palëve, janë duke u shqyrtuar nga ana e gjykatës, dhe këto procese akoma janë në zhvillim e sipër. Ju ftojme të gjeni bashkëlidhur paditë përkatëse. Për shkak të faktit se, çështjet që lidhen me punësimin dhe zgjidhjen e kontratës së punës me këtë shtetas janë objekt shqyrtimi gjyqësor në gjykatë, atëherë sipas nenit 17 pika 2 gërma dh) të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, informacioni dhe dokumentacioni i

kërkuar nuk i është vënë në dispozicion. Sqarojme se sipas nenit 223 të Kodit të Procedurës Civile, kërkesat për prova të cilat disponohen nga ana e IdentiTek, shqyrtohen nga gjykata dhe është kjo e fundit që vlerëson dhe vendos nëse kërkuesi, z. , ka legjitimitet dhe interes të ligjshëm për të kërkuar çdo dokumentacion apo informacion që disponohet nga ana e institucionit tonë. Bashkëlidhur, çështjet gjyqësore të poshtëshënuara: 1. Çështja nr. Regj. Themeli 18145, me palë: Paditës: Z. , i Paditur: Shoqëria IdentiTek sh.a. me status “në gjykim pranë Gjykatës së Shkallësë Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm.” 2. Çështja nr. Regj. Themeli 11055, me palë: Paditës: Z. , i Paditur: Shoqëria IdentiTek sh.a. me status “në gjykim pranë Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë.”...

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, ankuesi ka vijuar ankimin e tij nëpërmjet kërkesës së datës 09.09.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2007/3 prot., datë 11.09.2025, duke i qëndruar kërkesave të paraqitura në kërkesën e datës 11.06.2025.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës lidhet me “Akte dhe prova të gjeneruara dhe administruara nga ana e Autoritetit Publik...”.

Nga verifikimi paraprak, pika 2 e nenit 2 të LDI, parashikon se: “Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.”

Pika 3 e nenit 3 të LDI, parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.”

Neni 14 i ligjit 124/2024, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, parashikon: “1. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të marrë nga kontrolluesi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, një konfirmim nëse të dhënat personale në lidhje me të janë duke u përpunuar apo jo, si dhe, kur është rasti, të ketë akses në të dhënat personale dhe informacionin e mëposhtëm: a) qëllimin e përpunimit; b) ekzistencën dhe logjikën e vendimmarrjes automatike dhe të profilizimit, sipas pikave 1 e 3, të nenit 20 të këtij ligji, dhe, të paktën në ato raste, informacionin e duhur lidhur me logjikën përkatëse, si dhe rëndësinë e pasojat e parashikuara të këtij përpunimi për subjektin e të dhënave; c) afatin e parashikuar të ruajtjes së të dhënave personale ose, nëse kjo nuk është e mundur, kriteret që përdoren për të përcaktuar këtë afat; ç) bazën ligjore të përpunimit; d) kategoritë e të dhënave personale në fjalë, duke përfshirë, në rastet kur të dhënat personale nuk janë mbledhur nga subjekti i të dhënave, çdo informacion të disponueshëm për burimin e këtyre të dhënave; dh) marrësit ose kategoritë e marrësve, të cilëve u janë përhapur ose do t’u përhapen të dhënat personale, në veçanti, marrësit në vendet e huaja ose organizatat ndërkombëtare, përfshirë rastin kur të dhënat transferohen në vende të huaja dhe, nëse po, si sigurohet mbrojtja e duhur; e) ekzistencën e të drejtave sipas neneve 15–20 të këtij ligji dhe të drejtën për të paraqitur ankesë te Komisioneri. 2.

Kontrolluesi i ofron falas subjektit të të dhënave një kopje të listës së kategorive të të dhënave të përpunuara, duke treguar përmbajtjen e secilës kategori, që lidhet me subjektin e të dhënave dhe pa cenuar të drejtat dhe liritë themelore të personave të tjerë. Për çdo kopje të mëvonshme të kërkuar nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi mund të aplikojë një tarifë të arsyeshme në bazë të kostove administrative. Kur subjekti i të dhënave e bën kërkesën me mjete elektronike dhe nuk ka përcaktuar formë tjetër në të cilën kërkohet përgjigjja, informacioni ofrohet në formën elektronike që përdoret zakonisht.”

Neni 44 i ligjit 124/2024, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, parashikon se: “1. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale ushtrohet në harmoni me të drejtën e aksesit në dokumentet zyrtare dhe të drejtën e informimit, siç parashikohet në ligjin nr. 45/2022, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për aksesin në dokumentet zyrtare”, ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. 2. Aksesit i publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe aksesit i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh.”

Neni 3 pika 7 e “Kodit të Procedurave Administrative” parashikon se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3 të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.”

Në analizë të neneve të sipërcituara, informacioni/dokumentacioni i cili kërkohet nëpërmjet ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, nga ankuesi nëpërmjet ankesës nr. 2007 prot., datë 07.08.2025, duhet të kufizohet në informacion/dokumentacion, i cili reflekton punën e administratës publike, dhe që duhet të ketë një interes publik, ndërsa neni 14 i ligjit 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, parashikon rastet kur subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë nga kontrolluesi nëse të dhënat personale janë duke u përpunuar apo jo, si dhe, kur është rasti, të ketë akses në të dhënat personale të tij.

Për sa më sipër, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, dokumentacioni që kërkohet në pikat 1, 2, 3 dhe 5, ka të bëjë me referime të incidentëve të cilat pretendohen nga ankuesi se kanë ndodhur, duke kërkuar një hetim administrativ të brendshëm nga ana e shoqërisë IdentiTek sh.a..

IdentiTek sh.a. është një shoqëri aksionare e cila funksionon dhe rregullohet në bazë të ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe përkatësisht kreu V, nenet 105 e vijues rregullojnë funksionimin e shoqërisë aksionare dhe

përkatësisht nenet 135 e vijues përcaktojnë kompetencat e organeve drejtues të shoqërisë aksionare. Ligji i sipërpërmendur dhe rregullorja e brendshme e shoqërisë, përcaktojnë rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të hetimeve administrative, me krijimin e komisioneve ad hoc, të cilat do të hetojnë nëse ka pasur shkelje ose jo.

Bazuar në sa më sipër dhe në reference të pikës 7 të nenit 3 të “Kodit të Procedurave Administrative”, *palë* në hetimin administrativ do të konsiderohet IdentiTek sh.a. nëpërmjet personit/personave të autorizuar organet drejtuese të shoqërisë si dhe personit të cilit i cenohen interesat nga rezultati i procedurës.

Për sa më sipër, dokumentacioni i kërkuar në pikat 1, 2, 3 dhe 5, nuk mund të konsiderohet “informacion publik” në kuptim të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, si dhe duke qënë se ankuesi nuk është subjekt i të dhënave personale pasi nuk është *palë* në hetimin administrativ në kuptim të nenit të sipërcituar dhe ligjit 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, nuk garantohej e drejta e aksesit sipas nenit 14 të tij.

Referuar pikës nr. 5 të ankesës, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit arsyeton se, si *palë* në proceset gjyqësore: çështja nr. Regj. Themeli 18145, me *palë* paditëse: z. _____, *palë* të paditur: Shoqëria IdentiTek sh.a., në gjykim pranë Gjykatës së Shkallës Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm.” dhe çështjen nr. Regj. Themeli 11055, me *palë* paditëse: z. _____, *palë* të paditur: Shoqëria IdentiTek sh.a., në gjykim pranë Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë”, z. _____ i janë komunikuar të gjitha dokumentat e kërkuara në pikën 5 të kërkesës, kjo provuar dhe nga shkresa “Kërkesë me nr. 1175/3 prot., datë 19.08.2024”, paraqitur si provë pranë Zyrës së Komisionerit.

Sidoqoftë dokumentacioni i kërkuar në pikën 5 të ankesës, bën pjesë në rastet e kufizimit të informacionit referuar parashikimeve të nenit 17 të LDI, përkatësisht germës b të pikës 2 të nenit të sipërcituar, deri në përfundimin e proceseve gjyqësore.

Ndërkohë për sa i përket kërimit në lidhje me, listën e hyrje-daljeve të punonjësve në institucion në format elektronik dhe hard copy, Zyra e Komisionerit vlerëson se bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i cili parashikon se: “1. Punëdhënësi, gjatë marrëdhënieve të punës, nuk duhet të mbledhë informacione lidhur me punëmarrësit, përveç rasteve, kur këto informacione lidhen me aftësitë profesionale të punëmarrësve ose janë të nevojshme për zbatimin e kontratës. 2. Punëdhënësi është i detyruar të marrë masa sigurie për mbrojtjen e të dhënave personale të punëmarrësve që përpunohen në fushën e marrëdhënies së punës dhe në mënyrë të veçantë për të dhënat sensitive, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. 3. Punëdhënësi, që vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara të punëmarrësit, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit është i pakufizuar në kohë. 4. Të dhënat e përpunuara në dosjen e punëmarrësit, pas përfundimit të marrëdhënies së punës, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 146, të këtij Kodi, ruhen nga punëdhënësi për një periudhë 6-mujore nga data e marrjes së njoftimit nga punëdhënësi. 5. Në çdo rast tjetër, të dhënat personale të përpunuara në dosjen e

punëmarrësit ruhen deri në përfundim të marrëdhënies së punës. Përpunimi i të dhënave në tejkalim të këtij afati bëhet me marrjen e pëlqimit të punëmarrësit.”, dokumentacioni/informacioni i kërkuar duhet të kufizohet, pasi nuk mund të vihet në dispozicion pa pëlqimin paraprak të subjekteve të të dhënave dhe në rastin konkret, do të aplikohet pika 1 e gërmës “a” e nenit 17 të ligjit 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, që garanton të drejtën për një jetë private. Çështja e trajtuar nga Gjykata Europiane të Drejtësisë: Federación de Servicios de Comisiones Obreras (CCOO) v Deutsche Bank SAE, (arsyetimi dhe vendimi janë të aksesueshëm në linkun: <https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?jsessionid3B0A0FC2D7580D0E3811E3A8F0443D76?text=&docid=214043&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=2236952>), konsideron listat e hyrje-daljeve të kryera nga punonjësit, si një mjet opsional, i rregulluar nga Kodi i Punës, për zbatimin e detyrimeve kontraktuale të punonjësve, duke analizuar në tërësi kohën e punës së kryer etj., në përputhje dhe me udhëzimet e nxjerra nga Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (European Data Protection Supervisor), i cili në Udhëzimin e datës 11.07.2015, i aksesueshëm në linkun: **Error! Hyperlink reference not valid.**, konsideron vlerësimin e punës si përpunim të dhënash personale në tërësinë e aktit pasi: *“...vlerësimi i performancës së stafit, kryesisht përbëhet nga gjykime subjektive të eprorëve...”*. Rrjedhimisht Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka këshilluar që në formularin e vlerësimit të performancës së stafit të vendoset një klauzolë për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, duke garantuar të drejtën që të mos u përhapen tek të tretët pa u marrë pëlqimi paraprak i punonjësit. Lista ditore, mujore apo vjetore e hyrje-daljeve, do të lidhet ngushtësisht me marrëdhëniet kontraktuale midis punëmarrës dhe punëdhënës dhe si e tillë do të trajtohet si një element i të dhënave personale të mbrojtura nga pika 1 e gërmës “a” të nenit 17 të ligjit 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar dhe ligjit 124/2024, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Tërësia e akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përcjell frymën se përpunimi i të dhënave personale, si dhe vlerësimet, të cilat do të konsiderohen gjykime subjektive, përbëjnë të dhëna personale, dhe si të tilla nuk mund të përhapen pasi janë të dhëna të cilat janë mbledhur për një qëllim të caktuar dhe në asnjë mënyrë nuk mund të përhapen apo të publikohen pa u marrë pëlqimi i palëve.

Zyra e Komisionerit ka konsoliduar qëndimin e mësipërm edhe nëpërmjet vendimeve nr. 27, datë 19.08.2025, nr. 18, datë 15.10.2024, nr. 20, datë 22.10.2024, etj.

Për sa i përket sanksionimit me gjobë të administratorit në masën 4% të xhiros totale vjetore për vitin financiar paraardhës, kërkuar në pikën nr. 6 të ankesës, Zyra e Komisionerit vlerëson se në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, i cili përbën bazën ligjore me të cilën është depozituar ankesa, nuk mundet të aplikohen sanksionet e parashikuara nga një ligj tjetër (ligji nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Në cilin do rast sanksionimi i Autoritetit Publik, mbetet në diskrecion të Komisionerit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar në harmoni me parimet e sanksionuara në kreun II të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Theksojmë se objekti i LDI është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit administrativ, të cilat nuk bëjnë pjesë në rastet kufizuese të nenit 17 të ligjit 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, për sa më sipër parashtruar, rezultojnë se dokumentacioni i kërkuar nga ankuesi, nuk është dokumentacion me karakter publik në kuptim të ligjit, pasi bën pjesë në rastet kufizuese të parashikuara nga neni i sipërcituar.

Për rrjedhojë, për gjithë shkaqet e lartpërmendura, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 2007 prot., datë 07.08.2025, të z. _____, kundër Autoritetit Publik/IdentiTek sh.a., me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Kundër këtij vendimi pala ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 26.09.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi